



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
Njesia e Auditimit Brendshem

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2018

MIRATOHET
KRYETAR
Voltana ADEMI

PER : Kryetaren e Bashkisë Shkodër

PER DIJENI: Ministria e Financave
Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Kontrolluese
Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm
TIRANE

SUBJEKTI: Hartimi i Planit Strategjik për vitet 2019-2021 dhe planit vjetor për vitin 2019

Hyrje

Plani strategjik dhe vjetor, bazohet në procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe në Manualin e Auditimit Brendshëm.

Plani strategjik dhe vjetor, prezanton objektivat kryesorë, prioritetet dhe fushëveprimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm në Bashkinë Shkodër për periudhën 2019-2021. Plani strategjik është zhvilluar në bazë të vlersimit të rrezikut dhe në pajtim me Ligjin e Auditimit të Brendshëm, Standardet e Auditimit të Brendshëm, Kodin e etikës së Auditorëve të Brendshëm, Statutin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Metodologjinë për Auditimin e Brendshëm në Sektorin publik të përgatitur nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm.

Plani strategjik, siguron bazat për zhvillimin e Planeve vjetore të aktiviteteve të Auditimit të Brendshëm, të cilat do të përkufizojnë temën, fushëveprimin, objektivat dhe kërkesat e burimeve për implementimin e secilës detyrë të auditimit.

Planifikimi I Auditimit ne sektorin publik ne Bashkine Shkoder është një pjesë e rëndësishme e procesit të Auditimit. Ne planifikim përcakohet se si mund të përdoren më së miri burimet e auditimit në mënyrë që mjetet në dispozicion të auditimit të përdoren me efikasitet dhe efektivitet sa më të lartë në mënyrë që të bëhet e mundur shtimi I vleres se institucionit te Bashkise Shkoder.

Per kryerjen e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik do të angazhohen tre punonjës të ndarë në dy audit dhe një drejtues , të cilët janë të çertifikuar dhe të kualifikuar në fushat ekonomike e juridike.

I. PLANIT STRATEGJIK

I.1 Qëllimi

Qëllimi ynë në hartimin e planit strategjik, është të realizojmë, forcimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, shtimin e vlerës se institucioneve publike përmirësimin e qeverisjes, mbrojtjen e interesave të taksapaguesve, maksimizimin e kapaciteteve të ekipit auditues, dhe zgjerimin e mbështetjes në arritjen e objektivave të Bashkisë Shkoder dhe të institucioneve në vartësi të saj.

I.2 Misioni

Misioni I Njesisë Auditimit të Brendshëm, si pjesë e strukturës Bashkisë Shkodër është orientimi i veprimtarisë planifikuar në mënyrë të pavaruar dhe profesionale, duke i dhënë garanci të arsyeshme për efikasitetin, efektivitetin dhe ekonomicitetin e menaxhimit të burimeve, përmirësimin sistemet e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin e riskut. Kjo njësi , e realizon këtë mision duke zbatuar Kushtetutën dhe ligjet në fuqi, rregullat e tjera në fushën e procedurave të Auditimit, ndjekjen e praktikave më të mira bashkëkohore dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të Auditimit, me qëllim kontributin në përmirësimin e drejtimit,

I.3 Organizimi I Njesisë Auditimit Brendshëm.

Njësia e Auditimit Brendshëm në Bashkinë Shkodër është e organizuar në nivel sektori me vartësi direkte nga Kryetare e Bashkisë. Njësia përbëhet nga 3 punonjës, të ndarë në një drejtues dhe dy audite. Punonjësit janë çertifikuar si Audite si dhe të kualifikuar në fushat ekonomike e juridike.

I.4 Kuadri ligjor

Ligjin nr. 114/2015 “Per Auditimin e Brendshem ne sektorin publik” Urdhërin e Ministrisë financave nr. 100 datë 25.10.2018 “Për miratimin e manualit auditimit brendshem

në sektorin publik” V.K.M Nr. 83, date 03.02.2018 “Per miratimin e kritereve per ngritjen e njesive te auditimit te Brendshem ne Sektorin Publik”

I.5 Objektivat Strategjike.

Bazuar në misionin dhe vizionin , Njesia e Auditimit Brendshem, Bashkia Shkodër ka vendosur këto objektiva strategjike për periudhën 2019-2021, të cilat janë:

1. Të jetë në gjendje të shndërrojë totalisht veprimtarinë Audituese të orientuar nga vlerësimi i riskut dhe nga dobia për menaxhimin.
2. Të modernizojmë shërbimin e Auditimit duke synuar kompetencë të lartë, objektivitet maksimal dhe standarde të larta etike.
3. Të arrijmë të prodhojmë programe specifike të konsulencës për menaxhimin e lartë, për të gjitha fushat e financave publike.
4. Ngritja e kapaciteteve Audituese
5. Permiresimi I Standardet profesionale
6. Shkëmbimi i njohurive dhe përvojës me organizata te tjera homologe
7. Menaxhimi në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe efektive

I.6 Identifikimi I subjekteve

Plani strategjik është ndërtuar për një periudhë 3 vjecare (2+1), per vitet 2019- 2021, jane parashikuar per Auditim 38 subjekte, nga te cilat te 27 subjekte Bashkise Shkoder, 7 subjekte institucione ne vartesi te Bashkise, 3 sipermarrje qe financohen nga bashkia per kryerjen e sherbimeve publike, dhe një Shoqeri Anonime me kapital shtetëror mbi 50%. Per te tre vitet jane planifikuar te kryhen dhe angazhim keshillimi dhe sigurie, sipas rasteve te paraqitura.(bashkelidhet pasqyra nr.01)

Planifikimi Strategjik I ndare sipas viteve, është bere duke u bazuar ne nivelin e riskut që paraqesin subjektet që do të auditohen.

Per vitin 2019 jane planifikuar per auditim 12 subjekte, nga të cilat 9 angazhime auditimi perputhshmeri, 3 auditime të kombinuar,si dhe angazhim keshillimi e sigurie sipas rasteve te paraqitura dhe ndjekja e zbatimi I rekomandimeve. (bashkelidhet pasqyra nr.02)

I.7 Identifikimi I fushave apo sistemeve prioritare

Bashkia Shkodër, ka te identifikuar 48 subjekte te cilat janë objekt auditimit. Fushat per tu audituar do të jenë sistemet e kontrollit bredshëm, sistemi I proceseve organizative, perfshire personelin, buxhetimin dhe kryerjen e shpenziemve, sistemi I kontabiliteti dhe raportimit financiar, zbatimi I kontratave me te tretë etj.

I.8 Identifikimi dhe vlersimi I risqeve.

Identifikimi i risqeve është bërë bazuar në informacionet e mëparshme, si raportet e auditimit, informacionet zyrtare nga te trete. Për subjektet që do të auditohen është bërë vlerësim i përgjithshëm i riskut, duke bere ndarje sipas niveleve, ku ne nivel të lartë janë vlersuar subjektet te cilat nga informacionet e marra kane nevole emergente per rivlersim te aktivitetit te tyre.

Subjekte me nivel te mesem jane vlersuar, kryesisht, subjektet që në auditimet e mëparshme, kane patur me tepër mangesi teknike , dhe rrisku konsiston me tepër ne proceset organizative. Subjekte me risk të ulët janë vlersuar subjektet të cilat në auditimet e mëparshme nuk jane konstatuar mangesi serioze.

Ne subjektet e identifikuara per auditim per vitin 2019. janë vlersuar me risk te larte 3 subjekte, me risk te mesem 7 subjekte dhe me risk te ulet 2 subjekte. (bashkelidhet pasqyra nr.03).

I.9 Kufizimet e Auditimit.

Njësia e Auditimit – Bashkia Shkodër, është e pavaruar në kryerjen e misionit auditimit. Gjate kryerjes misionit auditimit në raste hasen pengesa në realizimin e objektivave , kryesisht ne venien ne kohë të dokumentaconit te nevojshem për auditim, paraqitja e argumenteve të ndryshme nga të audituarit, kundershime pa u bazuar ne fakte ligjore, Në raste mungon infrastruktura logjistike, pasi me ndarjen e re territoriale, Bashkia Shkoder ka subjekte me largësi deri 90 km. Gjithashtu një kufizim I rendesishem është dhe numri I auditeve, pasi me ndarjen e re administrative është dyfishuar numri I subjekteve per auditim, ndersa numri I auditueseve nuk ka ndryshuar.

I.10 Prioritetet per te ardhmen.

Njësia e Auditimit – Bashkia Shkodër, për të bërë të mundur përmirsimin e punës audituese, si prioritet kryesor do të kete:

- Përmirsimin e përgatitjes profesionale te auditeve, nëpërmjet kualifikimeve, në mënyre të vecante ne teknologjine e informacionit, në përdormimin e teknikave bashkekohore te auditmit.
- Konsulencve te vazhdueshme me drejtuesit e nivelit te ulet dhe te larte te Bashkise Shkoder per te bërë të mundur eliminimin ne kohe të mangësive.
- Analize e plote e problemeve te konstatuara gjate misioneve të auditimit, dhe gjetja e menyrave per përmirsimin e tyre.

II Plani vjetor

II.1 Zhvillimet aktuale te Njesise Auditimit - Bashkia Shkoder.

Njësia e Auditimit – Bashkia Shkodër, për vitin 2018 ka planifikuar për auditim 14 subjekte. Gjatë vitit 2018. Gjatë vitit 2018 me kërkesë të Kryetare Bashkisë Shkodër ka patur kërkesë për ndryshim të planit vjetor, në dy raste e konkretisht për auditimin e Drejtorisë Emergjencave Civile dhe për zyrën me një ndalesë Gjithashtu është rritur dhe kërkesa për angazhime keshillimi dhe sigurie.

II.2 Prioritetet e auditimit për vitin 2019.

Njësia e Auditimit – Bashkia Shkodër, për vitin 2019, si prioritet kryesor do të jetë kryerja e auditimeve për subjektet të cilat kanë rëndësi të vecante në arritjen e objektivave të Bashkisë Shkodëre konkretisht Drejtoria Kontrollit e zhvillimit territorit, Inspektoriatit Mbrojtjes territorit, Drejtoria e të Ardhurave

Prioritet të vecante do të jepet funksionimit të kontrollit të brendshëm dhe procedurave të kryerjes së shpenzimeve.

Për vitin 2019 do të ketë prioritet përmirimit standarteve profesionale, nëpërmjet kualifikimit.

II.3 Objektivat e auditimit për vitin 2019.

Për vitin 2019, Njësia e Auditimit- Bashkia Shkodër ka vendosur objektivat si më poshtë

1. Përmirësimi i standarteve profesionale.
2. Orientimi i auditimit në procese që kanë risk të lartë.
3. Dhenia e Rekomandimeve në përmirimin e punës.
4. Dhenia e këshillimit dhe sigurisë për Titullarin e Bashkisë Shkodër..

II.4 Programimi i llojit të angazhimeve.

Programimi i angazhimeve të auditimit për vitin 2019 është ndërtuar, bazuar në planin strategjik 2019-2021. Për vitin 2019 janë parashikuar për auditim 11 subjekte të cilat janë vlerësuar me risk të lartë 3 subjekte, me risk të mesëm 7 subjekte dhe me risk të ulët 2 subjekte.

Për vitin 2019 subjektet që do të auditohen janë kryesisht, drejtoritë rëndësishme të bashkisë dhe disa institucione vartësie të pa audituara gjatë vitit 2018.

Për vitin 2019, fushat që do të auditohen janë sistemi i kontrollit brendshëm, sistemi i proceseve organizative, përfshirë personelin, kryejnë e shpenzimeve me vlerë të ulët dhe të lartë, kryejnë e investimeve, sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar etj.

Subjektet do të auditohen nga një grup auditimi i përbërë nga dy audite. (bashkelidhet pasqyra nr.02).

II.5 Planifikimi i kostos për vitin 2019.

Per vitin 2019, është planifikuar nje kosto prej 2.610.878 lek e ndare ne 2.408.688 lek per paga e sigurime per nje drejtues dhe dy audite, udhetime e dieta per vlere 55.800 lek, ndara per 5 dite trajnime te panderprere, dhe 5 dite te tjera gjate vitit per nevoja te ndryshme. Gjithashtu shpenzimet administrative jane planifikuar per vlere 146.390 lek, te cilat janë kryesisht leter boje , materiale ndihmese. Kostoja mesatare per punonjes eshte 870.293 lek, ndersa kostoja per auditim është mesatarisht 185.651 lek. (Bashkelidhen tabelat 5,5/1,5/2,5/3).

II.6 Planifikimi i burimeve për vitin 2019.

Per vitin 2019, janë parashikuar 260 dite pune/person, jane zbritur pushimet vjetore 22 dite pune, Festat zyrtare 8 dite pune, kualifikimet e trajnimet 10 dite pune, takime te ndryshme 4 dite pune, raporta mjeksore 5 dite pune, të tjera 4 dite, ne total zbriten 54 dite pune. Per vitin 2019 jane planifikuar per auditim 206 dite pune per audit. (Bashkelidhet tabela nr.05.)

II.7 Planifikimi i nevojave të stafit për trajnim

Per vitin 2019 jane planifikuar 5 dite trajnime per te plotesuar dhe kerkesat ligjore prej 40 ore trajnime ne vit , si dhe 5 dite kualifikime te ndryshme te planifikuara nga Bashkia apo te trete. Propozimet per trajnime jane bere bazuar ne veshtersite e konstatuara gjate vitit 2018 dhe nevojat per trajnim. (bashkelidhet pasqyra nr.04).

II.8 Sigurimi i brendshëm i cilësisë

Sigurimi i brendshem i cilesisë do te kryehet ne dy nivele:

Ne nivelin e pare do te kryehet nga pergjegjesi i grupi i cili do te verifikoje procedurat e ndjekura ne mbeshtetje manualit auditimit dhe programit te angazhimit. Në këtë pjesë do të përcaktohen mënyra e se si do të planifikohet sigurimi i brendshëm i cilësisë nga ana e drejtuesit të NJAB.

Ne nivelin e dyte do të kryhet nga Përgjegjësi i Njesisë Auditimit i cili do te vlersoje te

procedurene ndjekur nga perpilimi i autorizimit deri ne dorezimin e plote te dosjes.

PERGJEGJESI

PELLUMB ZOGU